

VENDIM
Nr.213, datë 25.2.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS KURJAN, TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kurjan, të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Kurjan, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.36, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kurjan të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kurjan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kurjan

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
11-15	Prona që përdoren për realizimin e veprimeve social-kulturore e sportive.	Në pronësi
17-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
21-26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
28,29,35,37,38,40,41,43, 44,46,47,48,49,50,52,53,55,56	Troje të lira dhe hapësira dhe hapsira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
60-65	Varrezat publike	Në pronësi
66-72	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
91,96,111	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

112-115	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizime	Në pronësi
---------	---	------------